# DËSHMI ARKIVI

**A-478409**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vdekja e Giorgos Mazonakis/Mbyllet klinika ku kryheshin kimioterapi ilegale, pacientët trajtoheshin pa licencë! \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/vdekja-e-giorgos-mazonakis-mbyllet-klinika-ku-kryheshin-kimioterapi-ilegale-pacientet-trajtoheshin-pa-licence/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 08:48:48 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 08:37:49 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7b719618bc396cc1555ae2170c437833b5707fcbdd0c5ff2500cf982e6b3c88e` |
| TEKSTI | `54aa8c48d60146718c85d1b4d38e9362c0f7d12bc79ef98c4e0a3f807931a697` |
| PAMJA | `77c2d9ff7afeb835235edb3b2a4dfef625a3ec6b9e392fc12857424ae45c85c6` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `707f5bc1f0b38294a197863a039ced96f4d259f1fcfc889b15236eb94200e804` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/707f5bc1f0b38294a197863a039ced96f4d259f1fcfc889b15236eb94200e804`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Lajmet e fundit

## Vdekja e Giorgos Mazonakis/Mbyllet klinika ku kryheshin kimioterapi ilegale, pacientët trajtoheshin pa licencë!



*Marisa Karabeci*

*29 Shtator 2026*




Një kontroll i gjerë i strukturave private shëndetësore në Greqi ka zbuluar një rast të rëndë në Selanik, ku një klinikë private është urdhëruar të mbyllet pasi u konstatua se funksiononte në mënyrë të paligjshme një repart onkologjik. Kontrolli u krye nga Autoriteti Kombëtar i Transparencës dhe zbuloi se në klinikë kryheshin trajtime kimioterapie, ndonëse reparti onkologjik nuk ishte i përfshirë në licencën e institucionit. Sipas të dhënave të hetimit, klinika kishte pajisje të posaçme për përgatitjen e barnave kimioterapeutike. Në strukturë punonte edhe një pneumolog me specializim në onkologjinë e mushkërive, por pa një kontratë të shkruar me klinikën.

Dyshohet se që prej vitit 2022, mjeku përshkruante barna kimioterapie për pacientët, ndërsa trajtimet zhvilloheshin brenda repartit të paautorizuar. Kontrollet evidentuan edhe shkelje të tjera. Klinika nuk dispononte numrin e kërkuar të infermierëve, mungonin disa specialistë mjekësorë të parashikuar nga rregullat dhe nuk funksiononte Njësia e Kujdesit Intensiv, pavarësisht se ajo ishte pjesë e kushteve të licencimit.

Një tjetër element që po hetohet është trajtimi me kimioterapi i pacientëve të regjistruar me diagnoza që nuk lidheshin me sëmundjet onkologjike. Autoritetet po verifikojnë nëse për këto raste janë paraqitur të dhëna të pasakta pranë EOPYY, fondit publik të sigurimeve shëndetësore, me qëllim përfitimin e rimbursimeve. Problemet me klinikën ishin evidentuar edhe më herët. Në vitin 2025 ishte konstatuar mungesë personeli, ndërsa në fillim të vitit 2026 institucionit iu hoq certifikata e funksionimit të rregullt dhe iu rekomandua mbyllja. Pavarësisht kësaj, klinika vijoi aktivitetin.

Tashmë autoritetet kanë vendosur heqjen e licencës dhe mbylljen e saj, ndërsa materialet e çështjes

i janë përcjellë edhe Prokurorisë. Rasti është bërë pjesë e kontrolleve të shtuara në sektorin privat të shëndetësisë në Greqi, pas vdekjes së këngëtarit Giorgos Mazonakis në një qendër private në Athinë gjatë një procedure plazmafereze.

Pas ngjarjes, autoritetet nisën kontrolle në klinika dhe struktura të ndryshme private në të gjithë vendin. Përmes sistemit MedWatch janë evidentuar mijëra struktura që kërkojnë verifikim në terren. Në Atikë, 231 prej tyre janë klasifikuar si raste me prioritet të lartë për kontroll, ndërsa 424 të tjera janë futur në një kategori që kërkon rikontroll. Autoritetet kanë theksuar se klasifikimi në këto kategori nuk nënkupton automatikisht se strukturat janë të paligjshme, por se janë evidentuar elementë që kërkojnë verifikim të mëtejshëm. Kontrollet kanë përfshirë klinika, poliklinika, kabinete mjekësore, qendra estetike dhe biznese që reklamojnë shërbime shëndetësore pa autorizimet përkatëse.


LAJME TË NGJASHME



Vdekja e Giorgos Mazonakis, zbulohet mesazhi i fundit për trajtimin dhe pagesën…
1.5 MIN



Vdekja e Giorgos Mazonakis, dalin detaje të reja nga klinika: Defibrilatori nuk po funksiononte
1.5 MIN



Ndërroi jetë në një klinikë private, reagon për herë të parë nëna e të ndjerit Giorgos Mazonakis!
1.5 MIN



Detaje të tjera tronditëse nga klinika e mjekëve të arrestuar pas vdekjes së Giorgos Mazonakis!
3 MIN



Vdekja e këngëtarit grek Giorgos Mazonakis/Zbardhet dokumenti tronditës i Urgjencës!
1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Pranoi se është homoseksual, habit me deklaratën aktori i njohur: “E kishin më të lehtë të më shihnin si një…”



Vjeshta kalohet më bukur me muzikën e përzgjedhur nga DeeJay-t e TAR!



“Villa Sol Lumière”, një oaz paqeje larg kaosit të qytetit!



Nga dhoma e hotelit me Guardiolën te 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura te Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe!



Ben Affleck pranon se fëmijët qeshin me të kur përpiqet t’u japë këshilla për dashurinë?





Rita Ora tërheq vëmendjen me paraqitjen e fundit, vë në pah linjat trupore!



Vdekja e Giorgos Mazonakis, zbulohet mesazhi i fundit për trajtimin dhe pagesën…



“Para nga qielli”/Parashikimi i Baba Vanga-s për dy shenjat e zodiakut!




Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual!



“Patëm një dasmë të madhe shqiptare…”/ Dua Lipa ndan pamje nga dasma familjare!

## EDITORI SUGJERON



“Dashuria ma ngroh zemrën, shumica e vajzave janë të padashuruara”/Amber Candy: Kur sheh krevatin bosh në mëngjes…



Televizioni hapi i radhës? Amber zbulon ekskluzivisht projektin e ri: Njerëzit duan lumturi, një show që…



“Ku ka më mirë se të kesh një jetë të lirë?”/Amber: Djemtë shqiptarë kanë kompleks…



“Një njeri që ka ndryshuar identitetin…”/Amber Candy: Jam shumë e fortë për t'ia dalë në Shqipëri!



Flirt me ndonjë nga banorët? Amber: Më mirë t'i nxjerr vetë të palarat, se sa të m'i nxjerrin të tjerët…



“Në BBV kupton veten…”/Do të lidhej me një banor brenda shtëpisë? Amber: Unë godas që në fillim!



“Nuk duhet të rihyja, u stepa sepse…”/Amber Candy: Nuk mund të godasësh një banor që është i lodhur…



7 shenja që mund të tregojnë rezistencë ndaj insulinës!



Bëni kujdes!10 zakone të përditshme që mund të shkaktojnë rritje të sheqerit në gjak...



5 suplemente që mund të mbështesin efektin e ilaçeve për dobësim...

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.


**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873



**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.